

VENDIM
Nr. 39/2015

**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR ARRESTIMIN OSE HEQJEN E LIRISË, SI
DHE PËR TË USHTRUAR KONTROLL PERSONAL DHE TË BANESAVE TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, ZOTIT TOM DOSHI**

Në mbështetje të nenit 73, pikat 2 dhe 4, të Kushtetutës, nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pikat 4 dhe 5, të Rregullores së Kuvendit, me rekomandimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe për të ushtruar kontroll personal dhe të banesave të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Tom Doshi, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm me kërkesën nr. 1004/2 prot., datë 20.3.2015.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARI
Vangjel Dule

Miratuar në datën 26.3.2015